



COOPERATION AGREEMENT
BETWEEN
GARANTE / AUTHORITY FOR PERSONAL DATA PROTECTION OF
THE REPUBLIC OF ITALY
AND
INFORMATION AND DATA PROTECTION COMMISSIONER OF
THE REPUBLIC OF ALBANIA

Preface

Garante/Authority for Personal Data Protection of the Republic of Italy (Garante) and the Information and Data Protection Commissioner of the Republic of Albania (KDIMDP), hereinafter referred to as the parties;

- ∴ **Determined**, on mutual efforts to guarantee the rights and fundamental freedoms in general and on the lawful processing of personal data in particular;
- ∴ **Convinced**, that this agreement will develop and strengthen the relations between two counterpart authorities, in accordance with common interests;

Agree as follows:

Article 1 **Purpose and Scope**

The purpose of this Agreement is to promote co operation in conducting joint inspections/investigations in respect of controllers/companies operating within the territory of the Republic of Albania and process personal data of Italian and/or Albanian data subjects.

The co operation shall develop based upon this Agreement, also as regards the scope as follows:



- Exchange of know-how and experiences in developing inspections, in specific sectors processing personal data, in the framework of consolidating respective authorities activities;
- Work meetings according to the needs and context of specific procedures for handling complaints, in order to unify and implement joint actions;
- Assistance in drafting of reports after an analysis conducted by the Parties, regarding the processing of data by controllers/companies subject to inspection;
- Draw-up of newsletter decisions on inspections carried out;
- Communication and information exchange regarding the update of legal framework of both countries in this field;
- Collaboration for the arrangement of study visits of mutual interest and in full compliance with the purpose of this Agreement.

Article 2

Cooperation Procedure

For the purpose of this Agreement, each Party shall appoint one or more contact points. Contact points shall deal with the implementation of this Agreement.

The requests for cooperation must be introduced in English and Italian languages.

Any information transferred/exchanged should not be disclosed to third parties, without written consent of the transferring Party.

Contact points from both sides shall be available at any time for communication and coordination of actions with the other Party.

Article 3

Confidentiality

During the implementation of this Agreement, Parties may exchange information which they deem confidential. All data exchanged between Parties shall be considered confidential and shall be administrated by persons appointed by Parties to this Agreement, unless they are designated differently, in written form.



Article 4 Final Provisions

This Agreement shall enter into force upon its signature by the Parties and shall remain in force for an indefinite period of time.

This Agreement does not constitute an international agreement and does not establish rights and obligation arising from international law.

Each Party may terminate relations under this Memorandum, through addressing written notice to the other Party.

Signed in Rome on 10 February 2015 in 2 (two) original copies in English.

FOR
GARANTE
PERSONAL DATA PROTECTION AUTHORITY

Antonello **SORO**

FOR
INFORMATION AND DATA PROTECTION
COMMISSIONER

Besnik **DERVISHI**



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
GARANTES/KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE TË
REPUBLIKËS ITALIANE
DHE
KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Parathënie

Garante/Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Republikës Italiane (Garante) dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), më poshtë referuar si Palët;

- ∴ **Të vendosur**, mbi përpjekjet reciproke për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi dhe për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale në veçanti;
- ∴ **Të bindur**, që kjo Marrëveshje do të zhvillojë dhe forcojë marrëdhëniet mes dy autoriteteve homologe në përputhje me interesat e përbashkëta;

Bien dakord si vijon:

Neni 1

Qëllimi dhe Fusha e Veprimit

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është nxitja e bashkëpunimit në kryerjen e inspektimeve/mbikëqyrjeve të përbashkëta në respekt të kontrolluesve/kompanive italiane që ushtrojnë aktivitet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe përpunojnë të dhëna personale të subjekteve të të dhënave italianë dhe/apo shqiptarë.

Bashkëpunimi do të zhvillohet në bazë të kësaj Marrëveshjeje, edhe përsa i takon fushës së veprimit si vijon:



- Shkëmbimit të përvojave dhe eksperiencave në zhvillimet e inspektimeve, në sektorë të veçantë që përpunojnë të dhëna personale, në kuadër të konsolidimit të veprimtarisë respektive të punës së autoriteteve;
- Organizimit të takimeve të punës sipas nevojave dhe në kuadër të procedurave konkrete për shqyrtimin e ankesave për të njehsuar e zbatuar masa të përbashkëta;
- Asistencës në përgatitjen e raporteve pas një analize të kryer nga Palët lidhur me përpunimin e të dhënave nga kontrolluesit/kompanitë objekt inspektimi;
- Përgatitjes së buletineve të vendimeve mbi inspektimet e kryera;
- Komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit lidhur me përditësimin e kuadrit ligjor të të dy vendeve në këtë fushë;
- Bashkëpunimit për realizimin e vizitave studimore me interes reciprok e në përputhje të plotë me objektin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Procedura e Bashkëpunimit

Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje, secila Palë do të caktojë një ose shumë pika kontakti. Pikat e kontaktit do të merren me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Kërkesat për bashkëpunim paraqiten në gjuhën angleze dhe italiane.

Çdo informacion që transferohet/shkëmbehet nuk duhet t'u ekspozohet palëve të treta, pa dhënë për këtë aprovim me shkrim Pala transferuese.

Pikat e kontaktit nga të dyja Palët do të jenë të disponueshme në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin e veprimeve me Palën tjetër.

Neni 3

Konfidencialiteti

Gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, Palët mund të shkëmbejnë informacione të cilat ata i konsiderojnë konfidenciale. Të gjitha të dhënat e shkëmbyera midis Palëve do të konsiderohen konfidenciale dhe do të menaxhohen nga persona të caktuar nga Palët e kësaj Marrëveshjeje, përveç rasteve kur ato përcaktohen ndryshe me shkrim.



Neni 4 Dispozitat Përfundimtare

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të saj nga ana e Palëve dhe mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar kohe.

Kjo Marrëveshje nuk është një marrëveshje ndërkombëtare dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime që rrjedhin nga ligjet ndërkombëtare.

Çdo Palë mund të ndërpresë marrëdhëniet në bazë të këtij Memorandumi, duke i dhënë njoftim me shkrim Palës tjetër.

Nënshkruar në Romë, më 10 shkurt 2015 në 2 (dy) kopje origjinale, në gjuhën angleze.

*PËR
GARANTEN
AUTORITETIN PËR MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE*

Antonello **SORO**

*PËR
KOMISIONERIN
E TË DREJTËS PËR INFORMIM DHE
MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE*

Besnik **DERVISHI**